

**RELACION SHPJEGUES  
PËR PROJEKTVENDIMIN  
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI SHËRBIMET E  
DËRGESAVE TË PAKOVE POSTARE NDËRKUFITARE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi “Për miratimin e rregullores mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare” vjen si propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, bazuar në nenin 6, të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Projektvendimi synon përcaktimin e disa kërkesave specifike për nxitjen e ofrimit të shërbimeve më të mira postare për dërgesat ndërkufitare të pakove postare, në plotësim të rregullimeve të përcaktuara në ligjin nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Nevoja e këtij rregullimi lidhet zhvillimin e tregtisë elektronike (e-commerce) përmes përmirësimit të shërbimeve postare ndërkufitare.

Projektakti ka për qëllim të transpozojë Rregulloren nr. 2018/644/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 18 prill 2018: “Mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare” dhe është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian për vitin 2021.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projekt akti është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian në kapitullin 3: “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” për vitin 2021, dhe vjen si nevojë e plotësimit dhe përmirësimit të kërkesave për shërbimet postare ndërkufitare që lidhen me zhvillimin e tregtisë elektronike.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6 parashikon hartimin nga ana e ministrit përgjegjës për shërbimet postare të akteve ligjore e nënligjore si dhe të politikave të zhvillimit të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë.

Hartimi i këtij dokumenti del i nevojshëm në kuadër të plotësimit të rregullimeve për shërbimet postare që lidhen me zhvillimin e tregtisë elektronike (e-commerce) ku shërbimet postare ndërkufitare kanë një rol të rëndësishëm për sa i takon shpërndarjes së tyre.

Projekt akti transponon një rregullore të Bashkimit Evropian e cila është rekomanduar në progres raportin e BE-së për Shqipërinë në kapitullin 3.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projekt akti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe nenit 6, të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projekt akti synon përafrim të pjesshëm me Rregulloren nr. 2018/644/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 18 prill 2018: “Mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare” të BE-së.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi “*Për miratimin e rregullores mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare*” synon miratimin e rregullores mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare, e cila përmban 10 nene si më poshtë:

Në nenin 1, jepet objekti dhe qëllimi i rregullores që ka të bëjë me përcaktimin e disa kërkesave specifike për të nxitur ofrimin e shërbimeve më të mira të dërgesave ndërkufitare të pakove postare, përveç atyre të përcaktuara në ligjin për shërbimet postare. Këto kërkesa lidhen me:

- a) mbikëqyrjen rregullatore në lidhje me shërbimet e dërgesave të pakove postare;
- b) transparencën e tarifave dhe vlerësimin e tarifave për disa shërbime të dërgesave të pakove ndërkufitare me qëllim identifikimin e atyre të cilat janë të larta pa asnjë arsye;
- c) vënien në dispozicion të informacionit nga ana e ofruesve të shërbimeve për konsumatorët, në lidhje me shërbimet e dërgesave të pakove ndërkufitare.

Në nenin 2, jepen disa përkufizime plotësuese në kuptimin e kësaj rregulloreje dhe që lidhen në veçanti me dërgesat postare të pakove.

Në nenin 3, përcaktohen informacionet që ofruesit e shërbimit të dërgesave të pakove ndërkufitare duhet të paraqesin pranë organit rregullator në funksion të mbikëqyrjes rregullatore dhe rritjes së transparencës për shërbimet postare të dërgesave të pakove ndërkufitare.

Në nenin 4, parashikohet transparenca e tarifave për shërbimet e dërgesave ndërkufitare postare të pakove, si dhe publikimi i tyre nga AKEP.

Në nenin 5, parashikohet ndërmarrja e një procesi vlerësimi nga AKEP për tarifatat e dërgesave postare të pakove. Në veçanti ky parashikim lidhet me tarifatat e ofruesit të shërbimit që ka detyrimin e shërbimit universal postar.

Në nenin 6, parashikohet informacioni që duhet të ofrohet për konsumatorët. Ky rregullim vjen në plotësim të parashikimeve ligjore për mbrojtjen e konsumatorit. Qëllimi është që në mënyrë të veçantë informacioni të jepet për shërbimet e dërgesave postare ndërkufitare.

Në nenet 7, 8 dhe 9 rregullorja përfshin dispozita të fundit që lidhen me masat administrative sipas parashikimeve ligjore, zbatimin dhe detyrimin për konfidencialitetin konform parashikimeve ligjore në fuqi.

Neni 10, përcakton hyrjen në fuqi të rregullores me botimin e saj në fletoren zyrtare.

Dokumenti i rregullores shoqërohet dhe me një aneks ku jepet lista e objekteve postare të vetme për të cilat tarifatat e ofruesit të shërbimeve të dërgesave të pakove i nënshtrohen masave të transparencës së çmimeve dhe vlerësimit..

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projekt akti janë Ministri për Infrastrukturën dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit. Aktivitetet e parashikuara në aspektet rregullatore përbëjnë kosto administrative dhe do mbulohen nga buxheti respektiv i AKEP.

**MINISTRI  
PËR INFRASTRUKTURËN DHE ENERGJINË**

**BELINDA BALLUKU**